



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**V E N D I M**

Nr. 01, datë 10.11.2017

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “ZYRAT E REJA TË  
FEDERATËS SHQIPTARE TË FUTBOLLIT DHE RIKONSTRUKSIONI I FUSHAVE TË  
FUTBOLLIT, NDËRTIMI I TRIBUNËS DHE GODINËS SË AMBJENTEVE  
NDIHMËSE”, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Federatës Shqiptare të Futbollit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Zyrat e reja të Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Rikonstruksioni i Fushave të Futbollit, ndërtimi i Tribunës dhe godinës së ambjenteve ndihmëse”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues Federatën Shqiptare të Futbollit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet e Lejes së Ndërtimit do t’i jepen subjektit kërkues për secilën nga fazat të përcaktuara në hartën bashkëlidhur, vetëm pas:
  - a) miratimit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



**MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

**LINDITA NIKOLLA**



A circular official stamp in blue ink. The text around the perimeter reads "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" at the top and "MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË" at the bottom. In the center is the coat of arms of Albania. The stamp is partially obscured by a handwritten signature in blue ink.

**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**



A circular official stamp in blue ink. The text around the perimeter reads "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" at the top and "AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT" at the bottom. In the center is the coat of arms of Albania. The stamp is partially obscured by a handwritten signature in blue ink.